

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk
Adresa: Bulevardi Zogu i Parë, Pallati pranë Fakultetit të Shkencave,
Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Rikonstruksion i rrugës “Dalip Topi” (Pyjorja)”

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Rikonstruksion i rrugës “Dalip Topi” (Pyjorja)”.

Fondi limit: 14,734,701 (katërmëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e një) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2016, miratuar me VKB Nr. 58, datë 30.12.2015, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016 – 2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”.

Kohëzgjatja e kontratës: 4 (katër) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 23.12.2016, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 48 datë 05.12.2016.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk

NUIS K02017003I

Vlera e ofertës = **10,869,772** (dhjetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk

NUIS K51501008J

Vlera e ofertës = **13,333,333** (trembëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “Denis-05” shpk

NUIS K51518029B

Vlera e ofertës = **13,412,630** (trembëdhjetë milion e katërqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “Almo Konstruksion” shpk

NUIS J91915001P

Vlera e ofertës = **13,702,670** (trembëdhjetë milion e shtatëqind e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk

NUIS K51501008J

- Operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se ka të punësuar pranë shoqërisë 1 (një) punonjës pllakashtrues të pajisur me dëshmi kualifikimi lëshuar nga ISHTI, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.
- Referuar Shtojcës 9, (Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve), shoqëria “Sireta 2F” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) Fadromë me targë TR 6156 K. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetin e deklaruar si më lart konstatoi se Çertifikata e Kontrollit Teknik nuk është e vlefshme, pasi afati i vlefshmërisë së saj ka përfunduar më datë 20.12.2016. Gjithashtu Siguracioni i mjetit nuk është i vlefshëm, pasi afati i vlefshmërisë ka përfunduar më datë 15.12.2016. Nisur nga sa më lart, duke qenë se data e hapjes së ofertave për procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës “Dalip Topi” (Pyjorja)” ka qenë data 23.12.2016, shoqëria “Sireta 2F” shpk nuk plotëson DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 14, gërma “a”.
- Referuar Shtojcës 9, (Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve), shoqëria “Sireta 2F” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) Eskavatorë me goma. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetet e mësipërme konstatoi se mjeti i deklaruar sipas Shtojcës 9 Eskavator me targë ACMT 35, referuar Kontratës së qirasë me Nr. 5147 Rep. Nr. 3080 Kol. datë 06.05.2016 rezulton se është Fadromë dhe jo Eskavator. Referuar sa më lart, Shoqëria “Sireta 2F” shpk në bazë të dokumentacionit të paraqitur disponon vetëm 1 (një) Eskavator me goma dhe jo 2 (dy) ashtu siç ka deklaruar, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 14, në të cilën përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) Eskavatorë me goma”*.
- Sa më sipër, Operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk nuk ka kapacitetin e duhur teknik për objektin që prokurohet, pasi nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 14. Në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma (c) të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë

teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik “Almo Konstruksion” shpk

NUIS J91915001

- Operatori ekonomik “Almo Konstruksion” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se ka të punësuar pranë shoqërisë 1 (një) punonjës montator të pajisur me dëshmi kualifikimi lëshuar nga ISHTI, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk**, me adresë: **Bulevardi Zogu i Parë, Pallati pranë Fakultetit të Shkencave, Tiranë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **10,869,772** (dhjetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitörja “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **13,412,630** (trembëdhjetë milion e katërqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në Nenin 58 pika 5 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar).

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 30.12.2016

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.